



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 94, datë 13.06.2018**

**PËR**

**MIRATIMIN E DHËNIES SË ÇMIMIT NGA AMF PËR PUNIMIN MË TË MIRË TË  
PARAQITUR NË KONFERENCËN KOMBËTARE TË AMF-SË “SFIDAT E  
ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN E AMF-së DHE EDUKIMI  
FINANCIAR”**

Në bazë të nenit 14, pika 8 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe në zbatim të vendimit të Bordit të AMF-së nr. 128, datë 31.08.2017 “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (2017-2020)”, me propozim të Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e dhënies së çmimit nga AMF për punimin më të mirë të paraqitur në Konferencën Kombëtare të AMF-së “Sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF dhe edukimi financiar”, në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, në kuadër dhe në zbatim të strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje, (2017-2020)”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 128, datë 31.08.2017
2. Ngarkohet Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**